

PËRMBLEDHJE – JO TEKNIKE

&

DREJTORIA SHËRBIMIT SPITALOR GRAMSH.



INVESTITORI : DREJTORIA E SHERBIMIT SPITALOR GRAMSH

ADRESA: RRUGA LAGJA SPORTI GRAMSH,ELBASAN

ADMINISTRATORI: Qemal ZANI

Pamja e spitalit në ortofoto.



Drejtoria e shërbimit spitalor Gramsh është qendra shëndetësore që shërben për popullin e GRAMSHIT.

Kondicionet si dhe sipërfaqja e Spitalit.

Numri i pasurisë së Spitalit	9/49
Numri i kateve të ndërtesës.	2kate
Sipërfaqja e spitalit	8264m ²
Sipërfaqja e ndertimit	1800m ²
Sipërfaqe parkim lulishte	6000 m ²

Kufizimet .

Në veri kufizohet me rrugë.

Në lindje kufizohet me pasurinë nr 9/51,9/53.

Në perëndim kufizohet me pasurinë 9/36,9/38.

Në jug kufizohet me ndërtes private.

Kordinatat.

Nr	X	Y
1	4431479.80	4526155.49
2	4431550.27	4526146.05
3	4431558.96	4526058.11
4	4431476.27	4526066.99

Qendra Spitalore Gramshit , afron shërbimin shëndetsor për popullin e Gramshit me shumë shërbime shëndetsore të përgjithëshme dhe të specializuara.Si pjesë përbërëse e kësaj qëndreje janë:

- Spitali Pathologjik me 35 shtretër.
- Spitali Pediatrik me 25 shtretër.
- Spitali Obsetrik-gjinekologjik me 55 shtretër.
- Urgjenca me 5 shtretër.
- Guzhina .
- Lavanteria.
- Morgu.

Pavarësisht llojit të shërbimit shëndetsor që afron çdo lloj spitali, procedurat e pranimit të pacientit,të rregjistrimit dhe të vijimit të trajtimit të tij deri në shërim apo dalje nga spitali mbeten përgjithësisht të njëjta.Pacienti paraqitet për trajtim/shtrim në spital në bazë të rekomandimit të dhënë nga mjeku specialist i poliklinikës/ambulacës qëndrore të qytetit.

Ai i nënshtrohet kontrollit dhe analizave të përcaktuara nga mjeku specialist dhe sistemohet në një prej dhomave të pavionit të përcaktuar nga mjeku/apo kryeinfermeri. Pacienti trajtohet me mjekim, vizita mjeksore, analiza të ndryshme në vijmësi të ditëve të qëndrimit të tij në spital, derisa mjeku që e ndjek ecurinë e sëmundjes së tij, apo një grup mjekësh specialistë përcaktojnë nëse do vijoj trajtimi spitalor apo trajtimi i tij i mëtejshëm në kushtet e shtëpisë. E gjithë periudha e trajtimit të pacientit, është e pasqyruara në kartelën e tij personale mjeksore si dhe në rregjistrat e pavionit/spitalit. Dalja nga spitali shoqërohet me dokumentacionin përkatës, raport për pushime të paguara, këshillat mjeksore dhe ilaçet/medikamentet që duhet të vijnë të përdorë si dhe kohën e vizitës së ardhëshme/të radhës. Krahas me shërbimin mjeksor, pacientit i afrohet edhe shërbimi i higjienës personale si dhe ushqim. Pavionet/dhomat e spitaleve janë të pajisura me ambejnte të përshtatëshme hidro-sanitare, dhe personeli sanitar kryen shërbimin e pastrimit të tyre, dhomave të të sëmurëve e të personelit mjeksor, koridoret etj. Gjatë periudhave të caktuara në 24 orë. Po kështu pacientëve u afrohet ushqim në tre vakte, mëngjes, drekë dhe darkë, nga personeli i spitalit.

Laboratorët e analizave të gjakut, urinës.

Laboratorë të kësaj natyre gjenden në repartin e urgjencave si dhe në të gjithë spitalet. Këtu kryhen analizat e përcaktuara nga mjekët specialistë, ndaj një numuri të caktuar pacientësh, zakonisht në rastet e pranimeve/shtrimeve, në rastet kur kërkohen të bëhen ndërhyrje kirurgjikale, daljet nga spitali apo raste specifike. Analizat bëhen me metoda klasike apo nëpërmjet aparaturave bashkëkohore. Gjithsesi, në çdo rast krijohen mbetje nga pjesë të gjakut apo urinës së marrë si kampion, nga kimikate apo reagentë që përdoren gjatë analizës, doreza e mbetje të tjera plastike, age etj. Të gjitha këto mbetje, përfshihen në mbetjet spitalore dhe trajtohen nga personel i kualifikuar i cili bën ndarjen e tyre si dhe ambalazhimin në kontenjerët përkatës. Më pas këto mbetje magazinohen në një vend të përcaktuar nga Spitali dhe më pas terhiqen nga firma e licensuar MEDI-TEL. Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh ka një kontratë me firmën MEDI-TEL.

Laboratori i radiografisë, radioskopisë, egos.

Këta laboratorë i gjen në ambjentet e repartit të urgjencës. Pajisjet e tyre janë instaluar në ambiente të konceptuar dhe realizuar në përputhje me standartet e përcaktuara për të tillë veprimatri. Kështu sigurohet mos përhapje e rrezatimit të aparatit radioskopik apo radiografik jashtë ambientit ku ato janë vendosur, duke mos cënuar shëndetin e personelit që u shërben atyre dhe më gjërë.

Sallat kirurgjikale.

Sallat kirurgjikale, të lindjeve si dhe të mjekimeve të pjesëshme, gjenden tek Spitali Kirurgjisë, gjinekologjik, i urgjencave etj. Këto 5 salla janë të kompletuara me pajisjet bashkëkohore për kryerjen e të tilla shërbimeve. Në këto salla, krijohen mbetje të tilla si organe njerzore, mbetje të bandave të gjakut, mbetje plastike si doreza, kokore, përparëse, mjete prerëse si bisturi, age etj.

Të gjitha këto lloj mbetjesh spitalore trajtohen nga personel i kualifikuar, duke u seleksinuar dhe ambalazhuar në kontenierë të përshtatshëm për këto lloj mbetjesh.

Guzhina.

Në shërbim të pacientëve të shtruar në spital funksionon një guzhinë në të cilën pregatitet ushqim për tre vakte, sipas menisë së përcaktuar nga personeli administrativ përkatës. Në guzhinë janë instaluar pajisjet e nevojshme të gatimit si stufat me gaz dhe korent, pjatolarëse, frigoriferë të llojeve të ndryshme për mbajtjen e ushqimeve në ngrirje apo temperaturuar të përshtatshme ruajtje për kohë të përcaktuar etj. Në to gjenden edhe enë gatimi të formave e madhësive të ndryshme, pjata, karoca shpërndarëse etj. Këtu shërben një personel i specializuar kryesisht në përgatitjen e ushqimit si dhe në larjen e enëve. Ky personel prej 4 personash punon në dy turne (6 të mëngjezit deri në 22të darkës). Për të sëmurë të veçantë këtu pregatiten edhe ushqime dietike, sipas këshillave të mjekut që ndjek ecurinë e sëmundjes së tyre.

Lavateria.

Është një ambient në të cilin janë instaluar disa pajisje larëse, lavatriçe normale që përdoren edhe në familjet tona si dhe disa lavatriçe industriale, të vlerësuara nga kapaciteti relativisht i madh si dhe vetë madhësi e teshave që lahen në to. Këto pajisje janë relativisht të amortizuara dhe janë programuar të zëvendësohen gradualisht. Pajisjet janë me kapacitete relativisht të mëdha për vetë sasinë dhe natyrën e teshave që ato lajnë, kryesisht çarçafë krevatesh, këllëf jastikësh, batanije etj. Këtu punon një personel i specializuar prej 2 personash në punë me dy turne, në shërbim të gjithë spitaleve që mbulon kjo qëndër shëndetsore. Për larjen e teshave përdoren detergjentë të zakonshëm, nga ato që përdoren edhe në pastrimet kimike apo shtëpitë tona. Ujrat që dalin gjatë proçeve të larjes dhe tharjes shkarkohen drejtpërdrejt në rrjetin e kanalizimeve duke u bashkuar me ujrat e pastrimit të ambienteve si dhe me ujrat e zeza.

Tharja e teshave bëhet në dhomat tharëse, të ndërtuar me mure tulle dhe konstruksione metalike. Në dyshtet e dhomës së tharjes janë të instaluar rezistenca elektrike, të cilat krijojnë një temperaturë të përshtatëshme e të kontrolluar për tharjen e rrobave. Në pjesën tavanore janë instaluar aspiratorë të cilët bëjnë qarkullimin e ajrit në hapsirat punuese të dhomës së tharjes, duke bërë të mundur rënien e ajrit në kontakt të drejtpërdrejtë me teshat që thahen dhe largimin e lagështisë prej tyre. Punonjësja që punon këtu, nxjerr nga dhoma mbajtësen e caktuar, vendos mbi varësen e saj teshat që do të thahen dhe e fut përsëri mbajtësen në hapsirën punuese të dhomës së tharjes. Kështu, sipas një rradhe të caktuar ajo çvendos 4 konstruksionet metalike duke i ngarkuar me teshat të lagura dhe duke hequr prej tyre teshat e thara.

Një pjesë e caktuara e teshave të thara kalojnë më tej në proçesin e hekurosjes. Bëhet kujdesi i duhur, larja e seleksionuar e teshave jo vetëm sipas ngjyrave por edhe sipas përdorimit të tyre. Kështu psh, teshat që përdoren në sallat e kirurgjive pas larjes dërgohen në repartin e sterilizimit, për tju nënshtruar proçesit përkatës para përdorimit të tyre.

Morgu.

Është një repart i veçantë në shërbim të qëndrës spitalore por edhe për trajtimin e rasteve të veçanta të aksidenteve, mjeksisë ligjore etj. Në një godinë të veçuar një katëshe, ka hapsirë të përshtatëshme për trajtimin e disa trupave si dhe për ruajtjen e tyre Gjatë trajtimit të trupave

krijohen mbetje nga organet njerzore, kimikate apo medikamente që përdoren për pastrim apo analizim të tyre si dhe ujra që përdoren për pastrim. Mbetjet e organeve, bisturinë, dorezat plastike, trajtohen si mbetje spitalore nga personel i trajnuar. Ato seleksionohen dhe vendosen në kontenjerët përkatës, duke u etiketuar rast pas rasti. Më tej ato dërgohen në vendepoztimin e tyre të përkohëshëm nga ku merren çdo tre ditë nga kompania **MEDI-TEL sh.p.k** e cila bën përpunimin e tyre të mëtejshëm.

Repartet mirëmbajtëse

Infrastruktura e furnizimit dhe e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Qendra spitalore, vlerësohet objekt i rëndësisë së veçantë dhe për këtë arsye, ajo furnizohet nga dy drejtime/fidera të cilët punojnë sipas një regjimi të kontrolluar që nënkupton vënien në punë alternative të tyre. Më pas, furnizimi me rrymë elektrike bëhet me linja të veçanta për çdo godinë në përbërje të kësaj qëndre. Për shpërndarjen e energjisë elektrike në pajisjet punuese të çdo godine si dhe për ndriçimin e ambjenteve të brendëshme e të jashtme të tyre, shërben një rrjet i projektuar dhe i kompletuar me të gjitha pajisjet e duhura, duke siguruar një punë normale dhe pa rrezik për personelin dhe pacientët. Ky rrjet i brendëshëm shpërndarjeje, siguron punë të pavarur për çdo kat të godinave dhe në mjaft raste edhe të ambjenteve të veçanta të tyre, si sallat e kirurgjisë, laboratorë etj. Sallat e kirurgjisë kanë furnizim të dyfishtë si dhe një sistem furnizimi me gjenerator për të eliminuar kështu çdo rast ekstrem blekauti.

Infrastruktura e furnizimit dhe e shpërndarjes së ujit të pijshëm.

Furnizimi me ujë të pijshëm i të gjitha godinave përbërëse të qëndrës spitalore, bëhet nga rrjeti ujësjellës i qytetit, me një linjë të veçantë e cila siguron furnizim të pandërprerë gjatë 24 orëve. Nga kolektori kryesor i furnizimit të qëndrës, dalin linjat qëndrore/kryesore të cilat furnizojnë çdo godinë dhe, brenda tyre është ndërtuar rrjeti shpërndarës që dërgon ujin në pajisjet përkatëse të përdorimit të tij. Për të shmangur çdo pamundësi të furnizimit me ujë nga rrjeti furnizues i qytetit, në objekte të caktuara të qëndrës spitalore janë instaluar depozita uji, të cilat futen në funksionin në këto raste ekstreme. Të tilla depozita metalike, gjenden të vendosura në taracën e

objektit të guzhinës dhe të lavanterisë. Po kështu depozitë uji kemi në objektin ku është instaluar kaldaja, pranë spitalit të kirurgjisë dhe atij gjinekologjik.

Infrastruktura e rrjetit të shkarkimit të ujrave “të ndotur”.

Brenda çdo godine është ndërtuar një rrjet i brendëshëm i cili mbledh të gjitha llojet e ujrave “të ndotur” (ujrat që dalin nga pastrimi i ambjenteve, të dusheve, ujrata e zeza etj.) në një kolektor, i cili bashkohet me kolektorin e përgjithsëhm të qendrës. Më tej, të gjitha këto ujra të ndotur shkojnë në rrjetin e shkarkimit të ujrave të ndotur të qytetit

Rrjeti i tokëzimit.

I gjithë sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike, pajisjet e veçanta të tij si dhe godinat, janë të pajisura me një rrjet tokëzimi, i cili garanton mbrojtje të tyre nga mbingarkesat e rrymës elektrike si dhe nga shkarkimet atmosferike. Është e këshillueshme që ky rrjet, duhet të testohet në mënyrë periodike për vlerat e tij, nga specialistë të licencuar të fushës.

Infrastruktura plotësuese e qendrës spitalore.

Të gjitha sipërfaqet e pazëna me ndërtime, janë të organizuara sipas një projekti urbanistik, me rrugë të shtruara me asfalto-beton, si dhe me sipërfaqe të gjelbëruara e të mbjella me pemë dekorative. Rrygët janë të plotësuar me sistem ndriçimi, duke krijuar kështu një pejasazh të këndëshëm ditën dhe natën.

Aktiviteti apo veprimtaria e Qendrës Spitalore, ka të bëjë me kryerjen e shërbimit shëndetsor ndaj pacientëve me sëmundje, mosha dhe gjini të ndryshme. Në këtë veprimtari nuk ka asnjë lloj linje apo procesi përpunues e prodhues, kështu që nuk mund të bëjmë klasifikim të lëndëve të para e ndihmëse në kuptimin e tyre klasik.

Në këtë veprimtari përdoren gjërësish barna/ilaje/medikamente të gatshëm, të prodhuar e ambalazhuar nga firma të huaja e të importuara në vendin tonë. Blerja e tyre bëhet nga drejtoria përkatëse e Ministrisë së Shëndetsisë e cila kryen edhe transportin deri në farmacitë respektive të Qendrës Spitalore. Ambjente të farmacive respektive gjenden në çdo spital. Në to shërben personel i kualifikuar gjatë 24 orëve, i cili bën pregatitjen e sasive respektive të çdo bari/ilaji/medikamenti, sipas porosive të mjekëve të çdo pavioni. Në orare të përcaktuara nga

mjeku, infermeret përkatëse i japin barna/ilaçe/medikamente çdo pacienti. Çdo bar/ilaç/medikamen, vjen me dokumentin e tij shoqërues, kartelizohen në depon farmaceutike dhe shpërndahet po me dokument shoqërues në çdo spital dhe tek çdo personel që ka përgjegjësinë t'ja japë ato pacientëve.

Së bashku me barnat/ilaçet/medikamentet, trajtohen edhe pajisje apo instrumenta që përdor personeli mjeksor gjatë punës së tij. Kështu duhet të përmendim, termometra, aparate tensioni, age e bisturi etj. etj.

Administratori.

Drejtoria e Sherbimit Spitalore GRAMSH .

Qemal ZANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCËVE
DIREKTORIA E PËRGJITHSHMË TË TATIMEVE

NUMRI SERIAL:
640919600

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

Personi të Tatueshëm:
DIREKTORIA E SHËRIMIT
SPITALOR GRAMSH

Me adresë kryesore:
Rr. "AGJA SPOKTI" Nr.
GRAMSH GRAMSH

I jepet ky numër identifikimi (NIPT):
K96915891W

DATA E LËSHIMIT
15/07/2009



DEGA E TATIMEVE

Shkëlzen Dajç
(Emri Mbledhës)

Kjo certifikatë shërbon prova e Ministrisë së Financave dhe duhet të shërbet në rast të kësaj informacioni të ndryshëm derësi ose ndërkohësi të detyrimit ligjor për të qelur personin i tatueshëm.